

VENDIM
Nr. 803, datë 20.12.2021

**PËR CAKTIMIN E DISA ANËTARËVE TË BORDIT TË AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarëve të bordit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, sipas shkronjave “dh”, “ë”, “f” dhe “g”, të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, si më poshtë vijon:

a) znj. Alma Çupi, person publik nga fusha e medias;
b) përfaqësues shkencorë të fushave të ushqimit, ushqimit për kafshë, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve:

- i. znj. Erinda Lika, prof. asoc., pedagog në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare;
- ii. z. Kapllan Sula, prof. dr., pedagog në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit;
- iii. znj. Anila Kopali, prof. dr., pedagog në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit;
- iv. z. Seit Shallari, prof. dr., pedagog në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit;
- v. z. Shpend Shahini, prof. dr., pedagog në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit;
- c) znj. Ersida Teliti, përfaqësues i shoqatave të konsumatorëve;
- ç) z. Valentina Postoli, përfaqësues i shoqatave të agrobiznesit.

2. Vendimi nr. 128, datë 11.2.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e disa anëtarëve të bordit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj